

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, në lëndën penale kundër të akuzuarit B. S, me venbanim në Gj, për shkak të veprave penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nën paragrafi 1 paragrafi 1 të KPK-s, sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.1201/2010 e datës 03.09.2010 dhe PP.nr. 625/2011 e dates 13.04.2011 të cilën e përfaqësonte Prokurori Ismet Ukshini, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 18.04.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

I pandehuri B.S., nga i ati I, e ëma Xh, e lindur Sh, i lindur ..në Gj, ku dhe jetonka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes ekonomike të mesme, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, edhe më parë i dënuar për vepra të ngjashme penale dhe udhëhiqet procedurë edhe për veprë tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

I.

Sepse më datë 15-16.03.2010, në orët e vona të natës, në rr “..”, në Gj me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror, për vete apo për personin tjetër ka kryer vjedhje, në dëm të dëmtuarit S. N, në atë mënyrë që me përdorimin e forcës ka këputur tre dryra të derës të lokalit “...”, ka hapur derën me dhunë, ka thyer një xham, ka deportuar në brendi dhe nga aty ka marrë: cigare të llojeve të ndryshëm, si Marlboro të kuqe, Kent, Laki Straki, me ç’rast të dëmtuarit i është shkaktuar dëm në vlerë prej rreth 341euro.

Me çka ka kryer veprën penale, vjedhje e rëndë, nga neni 253 paragrafi 1 nën paragrafi 1 të KPRK-s.

II.

Sepse më datë 30.01.2011 rreth orës 12:30 min, në Gj., në rrugën Q....”, i pandehuri me qëllim që vetit ti sjelli përfitim të kundërligjshëm pasuror, në bashkëveprim me të miturin R.A. nga Gjilani, ka kryer vjedhje në dëm të të dëmtuarës E. Xh, në atë mënyrë që të njëjtit kishin shfrytëzuar mungesën e të dëmtuarës në shtëpi, të pandehurit përms garazhës, e më pas perms një dere të hapur me forcë, kanë depërtuar brenda në shtëpi duke demoluar gjësendet në dhoma dhe nga aty kanë vjedhur një llaptop nr.....me ngjyrë hiri, dhe një fotoaparar me shirit.

Me çka ka kryer veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nën paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 45, 73 dhe 75 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarin,

E G J Y K O N

I. Të akuzuarit B.S, për veprën penale nga dispozitivi **I** i këtij aktgjykimi i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

II. Për veprën penale nga dispozitivi **II** të këtij aktgjykimi i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

III. Në bazë të nenit 80 të KP-s, të akuzuarit B. S. i shqiptohet dënimi unik me burg në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në contest civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Kundër të akuzuarit në fjalë është ngritur akti akuzues lëndor për shkak të dyshimit të bazuar se i njejtë ka kryer veprat penale lëndore të përshkruara më gjërë si në pikpamje faktike ashtu edhe juridike në vet aktin e tillë shkresor.

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, të mbajtur më datën 18.04.2017, Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan Ismet Ukshini në fjalën përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës, dhe i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

I akuzuari Burim Sylejmani, në fjalën përfundimtare deklaroi: nuk e ndijë veten fajtor pasi që këto vepra nuk i kam kryer dhe kërkoj nga gjykata të më lirojë nga përgjegjësia penale.

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 361 të KPP, gjykata konstatoi këtë gjendje faktike : se është vërtetuar se i akuzuari B.S. nga Gj, i ka kryer veprat penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nën paragrafi 1 paragrafi 1 të KPK-s.

Këtë gjendje faktike, gjykata e konstatoi duke u bazuar në këto prova :

- Dëshmia dhe deklaratat e dëshmitarve B. S., T. Sh. dhe I.Sh.
- deklaratat e të dëmtuarve S. N e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës ..dhe ..në këtë gjykatë dhe Prokurori, dhe E. Xh. deklaratë e dhënë në Stacionin Policor në Gj.. me dt.....
- Shenimi zyrtar 1.1, skica nga vendi i ngjarjes, foto-dokumentacioni si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë,

Dëshmitari **B. S**, në shqyrtimin gjyqësor të datës 18.04.2017 deklaroi, lidhur me këtë rast unë kam dhënë deklaratë dhe mbetem në tërësi pranë asaj deklarate dhe më kujtohet se ditën kur ka ndodhur rasti ka qenë diku rreth orës 01,00 pas mesnate, prej pikës ku kam bërë sigurim unë ka qenë distanca 80 deri 100 m dhe unë e kam dëgjuar unë një zhurmë se është thyer diçka por nuk e kam ditur se është thyer lokali dhe në atë kohë dy persona prej asaj distance që e përmenda më lartë kanë kaluar në anën e kundërt të rrugës dhe pas 1-2 minutave prapë të njëjtit persona janë kthyer mbrapa te lokali i cili është thyer dhe ndërkohë ka kaluar një patrullë e policisë të cilëve ju kam raportuar lidhur me këtë rast dhe më tutje ata janë marrë me këtë rast. Unë nga kjo distancë nuk kam mundur me i identifikue ata dy persona pasi që ka qenë natë dhe kanë qenë me rroba të zeza, por e di që se kanë qenë më të gjatë se unë. Unë me atë rast u kam thënë policëve se dy persona kanë thyere diçka afër lokaleve pasi që e kam dëgjuar një zhurmë dhe shkoni se mund ti gjeni atje në vendin e ngjarjes ata persona. Pas kësaj policët kanë shkuar në drejtim të xhamisë së medresesë dhe aty kanë qëndruar rreth 15-20 minuta dhe pas gjysmë ore janë kthyer prapë te unë dhe më kanë treguar se ishte i thyer një lokal dhe nga unë i kanë marr shënimet personale.

Dëshmitari **T. Sh** në shqyrtimin gjyqësor të datës 18.04.2017 deklaroi: këtë rast e kam hetuar unë, në këtë rast kanë qenë dy të dyshuar i mituri R. A dhe B. Si, të dy nga Gj, të njëjtit janë intervistuar në njësitin e hetimeve për veprën e kryer më..., rreth orës 12,30, në lagjen..., në..., në këtë rast janë vjedhur një laptop dhe një fotoaparatur me shirit në dëm të ankueses E. Xh, pasi që kanë depërtuar mbrenda në shtëpi dhe të njëjtit i kanë marrë nga dhoma, në shtëpi kanë depërtuar nga pjesa e garazhes përmes një dëre e cila është hapur me dhunë dhe këtë vjedhje e kanë kryer i mituri R.A dhe

B. S. Të njëjtit e kanë pranuar gjatë intervistimit se e kanë kryer këtë vjedhje por nuk kanë treguar për vendndodhjen e lloptit dhe fotoaparatis prandaj edhe nuk kemi mundur ta marrim eventualisht blerësin e këtyre sendeve, pasi që njëjtit kanë deklaruar se kinse lloptin ia kanë shitur një personi të pa njohur nga Shkupi.

Dëshmitari **I. Sh.** në shqyrtimin gjyqësor të datës 18.04.2017 deklaroi: është e vërtetë se i mituri Rilind Abdullahu në prezencën e përfaqësuesit të tij ligjor-prindit e ka dhënë deklaratën ku ndër të tjera ka deklaruar në lidhje me vjedhjen që e ka kryer së bashku me B. S te e dëmtuara E, ku ka deklaruar se në atë shtëpi kanë vjedhur një lloptop ngjyrë hiri dhe një foto aparat, ngjyrë hiri i markës Canon, i njëjti ka deklaruar se lloptopin e ka shitur Burimi, por nuk i ka treguar se ku e ka shitur por i ka treguar vetëm shumën e shtijës të cilat para i kanë ndarë për gjysmë. Vjedhja ka ndodhur në rrugën qarkore në drejtim të fsh. L në anën e djathtë të rrugës më 30.01.2011 dhe për lloptopin kanë thënë që e kanë shitur ndërsa foto aparatin kanë deklaruar që e kanë hudhur pasi që nuk ka patur vlerë.

I pandehuri **B. S** gjatë mbrojtjes së tij e ka mohur veprën penale duke theksuar se nuk është e vërtetë se para policisë kam deklaruar se këtë vepër e kam kryer dhe mendoj se këtë deklaratë unë vetëm e kam nënshkruar pa e lexuar fare, dhe edhe njëherë po e përsërisë se as njëherë prej këtyre veprave nuk e kam kryer. Nuk e di se kush i ka kryer këto vepra dhe nuk më kujtohet se në atë kohë ku kam qenë pasi që ka kaluar një kohë e gjatë me Rilindin më herët jam njohur por asnjëherë me te nuk kam kryer vepra të vjedhjes.

Gjykata pas vlersimit të mbrojtjes së të pandehurit, vlersimit detal të provave të administruara me dëgjimin e dëshmitarve: B. S, T. Sh dhe I. Sh, si dhe me leximin e provave materiale: deklarata e të dëmtuarve Sali Nuhiu e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës ..dhe ..në këtë gjykatë dhe Prokurori, dhe E. Xh e dhënë në Stacionin Policor në Gj me dt. ..011 dhe Shenimi zyrtar ...skica nga vendi i ngjarjes, foto-dokumentacioni si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv I dhe II të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues deklaratës së dëshmitarveia fali besimin e plotë sepse deklaratat e të njejtve janë të logjikshme të plota dhe të drejta, meq në pika relavante përputhen me deklaratat e të dëmtuarve Sali Nuhiu dhe Enkeleda Xhemali. Shenimi zyrtar 1.1, skica nga vendi i ngjarjes, foto-dokumentacioni si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë,

Gjykata e shton besimin se vërtetë i pandehuri ka kryer vjedhjet e lartëshenuara te të dëmtuarët he dhe me këtë rast ju ka shkaktuar dëm material meq edhe një pjesë e deklaratës së të pandehurit R.A përputhet me deklaratat e dëshmitarve, i cili ka deklaruar, vjedhjen e ka kryer së bashku me Burim Sylejmanin te e dëmtuara E..., ku ka deklaruar se në atë shtëpi kanë vjedhur një lloptop ngjyrë ..dhe një foto aparat, ngjyrë .. i markës, i njëjti ka deklaruar se lloptopin e ka shitur B, por nuk i ka treguar se ku i ka shitur por i ka treguar vetëm shumën e shtijës të cilat para i kanë ndarë për gjysmë, nërsa fotoaparatin e kanë hudhur pasi që nuk ka patur vlerë. Këto vjedhje në deklaratën e dhënë në Stacionin Policor e ka pranuar edhe vet i akuzuari B... të cilën edhe e ka nënshkruar por në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se kinse nuk e ka lexuar deklaratën dhe vetëm e ka nënshkruar dhe se me R.... është shoqruar por kinse me te nuk ka kryer asnjëherë vjedhje.

Ky motiv i të pandehurit gjendjen faktike lidhur me këtë qështje penale e bënë më të besushme dhe më të plotë si tezë të vërtetuar nga gjykata përtej dyshimit të bazuar mirë.

Mbrojtjes së të pandehurit gjykata nuk ia fali besimin sepse e njejta është në kundërshtim me provat të cilave kjo gjykatë ju fali besimin dhe se mbrojtja e të pandehurit është e pa logjikshme, jo e besushme dhe se me këtë mbrojtje i pandehuri ka pasur për qëllim vetëm që gjykatën ta vëj në lajthim, sa për tui shmangur përgjegjësisë penale lidhur me veprën penale lëndore.

Gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të provave që jua fali besimin e plotë, vërtetoi gjendjen faktike sikurse në dispozitivin I dhe II të këtij aktgjykimi, duke vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit është përmbushur elementi objektiv i veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nën paragrafi 1 paragrafi 1 të KPK-s, nga ana e të pandehurit. Pastaj elementi subjektiv i cili konsiston në dashjen direkte, meq i pandehuri i ka kryer vjedhjet duke depërtuar brenda objekteve të dëmtuarve të lartë

cekur me forcë dhe duke i vjedhur gjërat e lartëpërmenduar duke ju shkaktuar dëm të konsiderueshëm të dëmtuarve për pëfitim të kundërligjshëm pasuror për vete edhe pse ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e ndaluar të tij.

Gjykata nuk ka vertetuar asnjë rrethanë e cila do ta përjashtonte ose esencialisht do ta zvogëlonte përgjegjësinë penale të pandehurit, andaj edhe ka vertetuar se i njejti është përgjegjës penalisht për veprat penale lëndore meq ka poseduar aftësinë mendore përkatsisht për gjykim.

Duke pasur parasysh provat të cilave kjo gjykatë ia fali besimin vërtetoi se në veprimet e të pandehurit janë përmbush të gjitha tiparet e figurës së veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nën paragrafi 1 paragrafi 1 të KPK-s, duke e shpallur fajtor dhe denuar të njejtin si në dispozitivit I dhe II të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit në kuptim të nenit 73 të KPRK-s, pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ndaj të akuzuarit, si rrethana lehtësuese mori parasysh: sjelljen korrekte në gjykatore, në kohën e kryerjes së veprave penale ka qenë i ri 19 vjeçar, nga koha e kryerjes së veprave penale kanë kaluar më tepër se gjashtë vite, ndërsa si rrethana rënduese mori parasysh shkalla e përgjegjësisë penale, rrezikshmëria shoqërore, dëmi i shkaktuar të dëmtuarve dhe se i pandehuri është recidivist.

Duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartë cekura gjykata, është bindur se me një dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 10 muaj, mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KP-s, se ky dënim është i drejtë, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe do ta parandalonte të akuzuarin që të mos kryej vepra penale.

Në kuptim të nenit 368 të KPP-s, palët u njoftuan se kanë të drejtë në ankesë, i cili udhëzim u shënua në procesverbal.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-s, kurse vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenit 463 paragrafi 2 të KPP-s.

Për arsyet e lartcekura u vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 678/2014, Më 18.04.2017

Sekretarja juridike,
Igballe Azemi d.v

Gjyqtari
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.

